



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.355/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Skenderaj, Bashkim Isufi, nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër KQZ-së, për shkak të certifikimit të listës së kandidatëve me numër të gabuar, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e pas afatshme apeli i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Skenderaj, Bashkim Isufi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, ZL.A.nr.355/2017, e paraqitur me datë 23.10.2017, kundër KQZ-së, për shkak të certifikimit të listës së kandidatëve me numër të gabuar, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë, nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal, në Skenderaj, Bashkim Isufi, nga subjekti politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën pretendon se në KKZ ka figuruar me numër 10 dhe me të njëjtin numër ka bërë fushatë, ndërsa në KQZ figuron me numër 09. Parashtuesi i ankesës thekson se kartelat dhe reklamat e tij gjatë fushatës i ka bërë me numrin 10. Më tej ka kërkuar që ti njihen votat me numër 10 dhe të rishikohet lista e KKZ-së në Skenderaj.

Subjekti politik AAK në përgjigje në ankesë, deklaroi me përgjegjësi të plotë se gabimi i bërë në radhitjen me numra të kandidatëve të AAK-së në Komunën e Skenderajt për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal është në përgjegjësinë e plotë të administratës së KQZ-së. Më tej pretendon se anëtarët e KKZ-së në Komunën e Skenderajt është dashur ti njoftojnë kandidatët e kësaj Komune për çfarëdo ndryshimi në listat zgjedhore, sepse ka mos përputhje në mes të listës së KKZ Skenderaj, dhe listës së KQZ-së edhe mospërputhja me listën e publikuar në WEB faqen e KQZ-së.

KQZ thekson se sa i përket pretendimit se kandidati për Anëtar të Kuvendit Komunal për Skenderaj, Bashkim Isufi nga radhët e subjektit politik AAK ka figuruar në listë me nr.10 ndërsa në listën e dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr.9, kjo ka ndodh me rastin e vendimit nr.1695/2017 të datës 16.09.2017, për decertifikim të kandidatit

lëvizja e numrave rendor të kandidatëve në këtë listë. Më tutje thekson se zyrtari i autorizuar i këtij subjekti politik, ka dëshmuar me shkrim që të bëhet lëvizja e numrit në listë. Po ashtu thekson se subjekti politik i certifikuar, mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së njoftim me shkrim jo më vonë se dy ditë të punës para datës së caktuar për tërheqje të shortit për zgjedhje, si dhe të gjitha kërkesat për të tërhequr një kandidat të certifikuar nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së. Më tej ka theksuar se KQZ nuk merr vendim për caktimin e numrave të kandidatëve të subjekteve politike, si dhe lista e kandidatëve të certifikuar nga KQZ është publikuar edhe në web faqen e KQZ-së

Me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të afatshmërisë, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apeleve, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Bashkim Isufi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik AAK, kundër KQZ-së, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve”*. Ngase prej shkresave të lëndës del se me datën 16.09.2017 është bërë decertifikimi i kandidatit me numër 7 i të njëjtit subjekt politik, pas këtij decertifikimi kandidatëve të tjerë u është ndryshuar numri me të cilën lista e kandidatëve është bërë publike me datën 25.09.2017, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë pas publikimit të vendimit të KQZ-së. Apeli në PZAP është paraqitur me datën 23.10.2017, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar me dispozitën Ligjore të nenit 122 pa.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 115.1 dhe 122.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.A.nr. 355/2017 më datën 25.10.2017

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.